



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2482, datë 15.05.2014

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a., ndaj Vendimit nr. 2431, datë 13.3.2014 dhe Vendimit nr. 2433 datë 13.3.2014”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 15.05.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimi i ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a., ndaj Vendimit nr. 2431, datë 13.3.2014 dhe Vendimit nr. 2433 datë 13.3.2014.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e AMC me nr. 337/1Prot., datë 10.4.2014 (nr. 1000Prot. i AKEP, datë 11.4.2014) me anë të së cilës ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimeve të AKEP nr. 2412 datë 16.1.2014, VKD nr. 2431 datë 13.3.2014 dhe VKD nr. 2433 datë 13.3.2014;
2. VKD nr. 2412, datë 16.1.2014 për “*Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*”;
3. VKD nr. 2431 datë 13.3.2014 për “*Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për “Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*” dhe
4. VKD nr. 2433 datë 13.3.2014, për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.*”
5. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Albanian Mobile Communications sh.a. me anë të shkresës nr. 337/1Prot., datë 10.4.2014 (protokolli i AKEP: nr.1000, datw 11.03.2014), ka paraqitur ankim administrativ ndaj Vendimeve të AKEP, përkatësisht:
 - VKD nr. 2412, datë 16.1.2014 për “*Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*”;
 - VKD nr. 2431 datë 13.3.2014 për “*Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për “Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”*” dhe
 - VKD nr. 2433 datë 13.3.2014, për “*Miratimin e rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.*”
2. AMC, e argumenton ankimin administrativ si më poshtë vijon:
 - AMC shprehet se në komentet e saj të dërguara më 12.2.2014, rishikimi i metodologjisë Benchmark sipas tarifave mesatare të BE- së, për të rishikuar tarifat e terminimit në rrjetet celulare është i pajustificuar nga pikëpamja rregullatore në dritën e kuadrit rregullator të vendit tonë dhe atij të BE dhe i pabazuar në ligj e në aktet rregullatore të BE, kur tashmë tarifat e terminimit në këto rrjete janë të përllogaritura në baze të metodologjisë BULRAIC sipas *glide path-it* të analizës së tregut celular Korrik 2012 dhe më konkretisht: Vendimet e AKEP nga 2119 deri 2122, dt. 04.07.2012 (për deklarinimin me FNT respektivisht për AMC, Eagle Mobile, Plus Communication dhe Vodafone Albania).
 - AMC shprehet se nuk është e konceptueshme një rikthim i përdorimit të metodologjisë së Benchmark, kur kjo bazë përllogaritjeje është ekzistuese dhe e sanksionuar me vendimet e AKEP të cilat parashikojnë aplikimin e tarifave të terminimit deri në 2015.
 - Neni 7 i Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 “ Pëe komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” përcakton se AKEP në ushtrimin e funksioneve të tij duhet të marrë parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Europian dhe BEREC. Në kuader, të përcaktimit të tregjeve dhe rregullimit të tyre AKEP duhet të ketë parasysh tekomandimet e BE.
 - AMC shpjegon se në nenin 45, 49 dhe 57 del shumë qartë kërkesa për aplikimin e parimit të orientimit drejt kostos dhe preferencën për metodologji të saktë të

kalkulimit të këtyre kostove. Vlen të përmendet se AKEP ka shpenzuar vlera të konsiderueshme të financave publike për mbulimin e kostos së konsulences nderkombetare për hartimin e BULRAIC. Kjo metodologji dhe zbatimi i saj ka kërkuar gjithashtu dhe një shpenzim të konsiderueshëm financiar dhe nga operatorët. Për keto arsye e gjejmë të pajustificuar rikthimin të një metodologji të re bazuar në metodat krahasimore.

- AMC shprehet se AKEP nuk ka bërë asnjë rillogaritje për përcaktimin e kostove të terminimit sipas metodologjisë LRIC të pastër duke iu rikthyer metodes Benchmark për përcaktimin e tarifave të terminimit përpara vitit 2010, vit në të cilin u implementua BULRIC. Argumentet e dhëna nga AKEP për kohën e kufizuar për ndërtimin e një modeli BULRAIC të pastër nuk kanë kuptim pasi *glide path-i* aktual për tarifën e terminimit ka akoma dhe 2 vjet afat deri në konvergimin e plotë të tyre (1.09.2015) Kohë e cila është e mjaftueshme për ndërtimin dhe implementimin e këtij modeli dhe rillogaritjen e tarifave të terminimit.
- Një tjetër aspekt, shprehet AMC, ka të bëjë me momentin në të cilin AKEP ka vendosur të rishikojë keto tarifa, pa zhvilluar më parë një analizë të plotë të telefonisë celulare duke shkelur dhe afatet kohore të parashikuara nga ligji 9919, neni 34/1, midis dy analizave të njëpasnjëshme të tregut që është mbi 2 vjet. Pra sic parashikohet në nenin 34/1, AKEP ka shkelur në mënyrë të hapur ligjin nr. 9918, që i referohet periodicitetit për kryerjen e analizës së tregut si dhe nenin 16, par.6/a të Direktives 2002/21 Te BE, e amenduar nga Direktiva 2009/140/EC Në lidhje me këtë pikë si me poshtë:
- AMC shpjegon se, krahasimi i tregut celular në Shqipëri me tregje të tjera celulare të shumë vendeve të BE nuk qëndron për shkak të karakteristikave të ndryshme që kanë vendet E BE-se me Shqipërinë në lidhje me tregjet celulare, pasi keto vende kanë një zhvillim ekonomik me standarte më të larta si në terma të PBB, ashtu dhe të të ardhurave për frymë, dhe kjo çon në konkluzione të gabuara pasi nuk mund të krahasohen me vende që nuk kanë asnjë ngjashmëri midis tyre për t'i përdorur si benchmark në përcaktimin e tarifave të terminimit në tregun celular. Kjo papërshtatshmëri bëhet dhe më e thellë nëse marrim parasysh dhe stadin aktual të zhvillimit të tregut të telekomunikacioneve në Shqipëri dhe vendet e BE.
- Për më tepër kjo bie në kundërshtim me praktikën e ndjekur më parë nga AKEP në analizat e këtij tregu i cili ka përdorur gjithmonë si referencë krahasuese vendet e rajonit që kanë karakteristika të ngjashme me vendin tonë.
- Niveli aktual i tarifës së terminimit 4.57 lekë/min (*3.264 eurocent/min*) është i ngjashëm ose më i ulët, krahasuar me atë të disa vendeve si: Serbia, Maqedonia, Sllovenia (*referuar dokumentit periodik të BEREC "BoR (13) 178 November 2013*).
- AMC shpjegon se, shumica e vendeve fqinj si dhe vendet e BE kanë tashmë të implementuar metodologjinë e përcaktimit të tarifave të terminimit mobile bazuar në kosto, ashtu siç përcaktohet në kuadrin rregullator të BE dhe në asnjë nga këto vende nuk gjenden praktika të rikthimit të kontrollit dhe përcaktimit të tarifave nga metodologjitë LRIC, në atë të benchmark, që të justifikonte një veprim të tillë të AKEP.
- AMC shprehet se nuk është dakord me asnjë nga nivelet Benchmark të propozuar nga AKEP, pasi tarifën e terminimit janë të rregulluara dhe të llogaritura sipas kostos së operatorëve bazuar në metodologjinë BULRAIC implementuar nga AKEP në 2010 si dhe *glide path-i*, në të cilin tarifën e terminimit celular bazohen për të katër operatorët celulare në nivelin 4.57 lekë/min duke u arritur kështu simetria e plotë në këtë nivel.

- AMC shpjegon se vendosja e tarifave sipas metodës benchmark, (*sic verehet në dokumentin për këshillim publik*) rrit në nivele mjaft të larta asimetrinë midis operatoreve duke i vendosur ata qartë në pozita diskriminuese dhe duke dëmtuar konkurrencën midis palëve, respektivisht AMC/Vodafone ndaj dy operatorëve të tjerë Albtelecom EM/Plus, ku në rastin AMC/Vodafone – Albtelecom (EM) niveli i asimetrisë nga 0% shkon në 51% gjatë fazës së parë deri në 1.03.2014 dhe në 104% nga 1.03.2014 – 1.01.2015. Ndërsa në rastin Plus-AMC/ Vodafone ky nivel rritet në mënyrë tepër të skajshme nga 90% deri në 170% në 1.01.2015, nivel që nuk vërehet në asnjë nga vendet e BE apo të rajonit me përjashtim të Turqisë, Maqedonisë dhe Luksemburgut. Në të gjitha vendet e tjera tarifat e terminimit janë plotësisht simetrike. Ndërsa në vendet (Luksemburg, Maqedoni, Turqi) në të cilat ka ende nivel asimerie midis tarifave të terminimit, niveli i tyre është i ulët.
- Niveli i asimetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet mobile në të gjitha këto vende ka ardhur gjithnjë e më shumë deri në arritjen e një simetrie të plotë në mbi 90% të vendeve të BE dhe të rajonit, në kah të kundërt me atë që propozon AKEP, ku niveli i asimetrisë rritet deri në nivele ekstreme, krejtësisht të pajustificueshme, i bazuar në asnjë lloj metodologjie duke favorizuar qarte dy operatorët e tjerë Albtelecom/EM (*veçanërisht këtë operator*) dhe Plus në dëm të AMC. Ndaj dhe propozimi i niveleve Benchmark të tarifave të terminimit nga AKEP, shprehet AMC, nuk është aspak i përshtatshëm, për arsye se AKEP nuk ka bërë asnjë përllogaritje të kostove përkatëse për përcaktimin e këtyre tarifave, duke iu referuar thjesht mesatares së përgjithshme të BE dhe të vendeve të rajonit, duke iu tikuhyer një situatë të më shumë se 3 viteve para kur nuk kishte asnjë metodologji për përllogaritjen e kostove të terminimit, e cila justifikonte përdorimin e metodologjise Benchmark për rregulimin e tarifave të terminimit deri në implementimin e BULRAIC dhe duke mos u bazuar në asnjë praktikë të ngjashme me vende të tjera por dhe duke shkelur *glide path-in* e përcaktuar nga vetë AKEP .
- AMC shprehet se, AKEP nuk e ka marrë parasysh këtë arsyetim të AMC, dhe në vend që ta bazonte vendimin përfundimtar mbi atë çfarë kishte propozuar në konsultim publik, merr një vendim ku tarifa e terminimit reduktohet më tej në dëm të AMC nga 3.03 leke/min në 2.66 leke/min me rreth 12% ulje të mëtejshme dhe 42% ulje nga tarifa aktuale (4.57 leke/min) duke mbajtur të njëjtin nivel asimetrie me EM, duke thelluar nivelin e asimetrisë me Plus nga 116% të propozuar 145%.
- AMC, shprehet se AKEP, në qëndrimin e tij në dokumentin final ndaj komenteve të AMC në Vendimin nr. 2431, dt.13.03.2014, mbështet dhe justifikon propozimet e tij në lidhje me rikthimin e përdorimit të metodologjisë benchmark në rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare duke dhënë si referencë dhe zhvillimet në vendet e rajonit (fq. 9). AKEP në dokumentin e publikuar ka marrë në konsideratë edhe vendet e rajonit, si Kroacia, Turqia dhe Maqedonia. Maqedonia sic është përmendur edhe në dokumentin e njerrë në këshillim publik ka një tarifë mesatare aktuale prej 5.7 eurocent, por edhe në shtator 2014 kjo tarifë do të reduktohet në 1.46 eurocent pra një reduktim me 74%. Duke iu referuar zhvillimeve rregullatore, sipas raportit të Cullen International vendet si: Islanda, Kroacia, Mali I Zi, BH dhe Maqedonia kanë tashmë tarifa të terminimit simetrike midis gjithë operatorëve. Pra në asnjë nga këto vende nuk ndeshet një rivendosje e asimetrisë në momentin që këto tarifa janë përcaktuar me anë të një *glide path-I* drejt reduktimit të nivelit të asimetrisë dhe vendosjes së asimetrisë së plotë.
- AMC shprehet se, përcaktimi final i tarifave të terminimit nga ana e AKEP, i cili ndryshon nga c'ka propozuar në dokumentin për konsultim publik, ka rivendosur asimetrinë e tarifave midis AMC dhe Eagle Mobile, kur dihet që ky operator është aktiv në treg që në vitin 2008, me një pozitë të konsoliduar financiare dhe të

- abonentëve, veprim ky i cili nuk ndeshet në asnjë nga vendet e rajonit apo të vëndeve të BE.
- AMC shprehet se, AKEP ka thelluar më tej nivelin e asimetrise midis AMC dhe Plus, duke e zgjatur dhe me një vit më tepër nivelin e asimetrisë sec ka qënë vendosur me glide path-in e përcaktuar në vendimet 2118- 2122, dt. 04.07.2012.
 - AMC, (duke iu referuar fq. 33 të dokumentit mbi komentet e operatorëve) shprehet se qëndrimi i AKEP bie në kundërshtim të plotë me Rekomandimin e KE të vitit 2009 pika 10, në të cilin përcaktohet një periudhë kohore që nuk duhet të jetë më shumë se 4 vjet pas hyrjes në treg të operatorit më të ri për nivelin e asimetrisë në tarifatat e terminimit në rrjetet e telefonisë celulare.
 - AMC shprehet se në lidhje me pyetjen nr. 3, të saj, AKEP nuk sqaron dhe nuk argumenton asgjë në lidhje me propozimin e bërë për këtë gjë në konsultimin publik, pasi nuk ofron asnjë evidencë apo justifikim të cdo lloji qoftë për të mbështetur qëndrimin e tij. AMC i referohet për këtë edhe Rekomandimit të BE (2009) që thekson që kjo gjë bëhet veten në rrethana të jashtëzakonshme për shkak të burimeve të kufizuara apo kohës jo të mjaftueshme.
 - AMC, shpjegon se, Rekomandimi i KE 2009 në nenet 2 dhe 6 përcakton metodologjinë LRIC të pastër për përcaktimin e tarifave të terminimit, citon se çdo ent rregullator që devijon nga ky model kosto, duhet të japë arsye dhe argumentat të forta dhe biznese se përse një metodologji tjetër është me e përshtatshme se metodologjia aktuale BULRAIC, gjë të cilën AKEP nuk e ka reflektuar në dokumentin final në lidhje me qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje.
 - Ndërkohë shpjegon AMC, AKEP nuk ka publikuar ende raportin mbi situatën e komunikimeve elektronike për vitin 2013, duke e marrë këtë vendim në mënyrë arbitrare dhe të parakohshme, në kundërshtim me kuadrin rregullator referuar pikës nr. 1 të Rek. BE 2009.
 - AMC, shprehet se AKEP me anë të këtij qëndrimi mbetet në shkelje të hapur të kësaj dispozite rregullatore, ku theksohet qartë që përcaktimi i kontrollit të tarifave për një operator me FNT bëhet si rezultat i një analize tregu të kryer me parë, gjë të cilën AKEP nuk e ka bërë pasi dhe afatet kohore që nga analiza e fundit e tregut nuk janë plotësuar akoma (korrik 2012) si dhe kur akoma nuk janë publikuar të dhënat statistikore të tregut për vitin 2013, mbi të cilën duhet të ishte bazuar AKEP në përcaktimin final të tarifave të terminimit në rrjetet e telefonisë celulare mbi bazen e një modeli kostoje të përgatitur dhe jo sipas niveleve Benchmark të përcaktuara nga AKEP.
 - AMC thekson se nivelet e tarifave të përcaktuara nga AKEP janë arbitrare dhe të paargumentuara, të pabazuara në asnjë model kostoje, duke rivendosur në mënyrë përfundimtare me anë të këtij vendimi nivele të larta të asimetrisë midis AMC dhe Plus. Duke favorizuar qartë dy operatorët e tjerë Eagle Mobile dhe Plus, në dëm të dy operatorëve të tjerë AMC dhe Vodafone, e duke lënë kështu në pozita diskriminuese AMC .
 - AMC shprehet se AKEP në përcaktimin e tarifave të reja të terminimit duhej t'i përmbahej kuadrin rregullator që parashikon implementimin e një modeli kosto LRIC i pastër sipas rekomandimit të BE 2009 në mënyrë që të llogariten kostot e reja të terminimit duke marrë në konsideratë faktorë si: lancimi në treg i teknologjive të reja (3G, rrjeteve NGN, etj), portabilitetit të numrit etj.
 - AMC shprehet se ky vendim përfundimtar i AKEP, shkakton jo vetëm dëmtim dhe cënim të pozitës financiare të AMC në treg, por dhe një pasiguri në zhvillimin e planeve të biznesit në të ardhmen, dëmton konkurrencën e lire midis operatorëve duke mos i vendosur ata në pozita të barabarta, gjë që nuk është marrë në

- konsideratë nga ana e AKEP në këtë vendim dhe në qëndrimet e dhëna ne lidhje me këtë çështje.
- AMC është shprehur edhe në komentete saj se nuk ekzistojnë më kushtet për rivendosjen e asimetrisë së tarifave të terminimit midis operatoreve, pasi operatorët Plus dhe Eagle Mobile janë aktiv në treg prej disa vitesh, fakt i cili nuk e justifikon me vendosjen e asimetrisë së tarifave të terminimit, duke qënë se Plus ka që në vitin 2010 që operon në treg dhe Eagle operon tashmë prej më shumë se 6 vjet.
 - AMC shprehet se AKEP as në qëndrimet e tij ndaj komenteve tona, nuk ofruar asnjë lloj argumenti, fakti se ku e mbështet nje vendim të tillë dhe referencat rregullatore të përmendura nga AKEP nuk i evidentojnë këto përfundime të AKEP, duke vendosur kështu AKEP në shkelje të të gjithë parimeve të kuadrit rregullator si të BE dhe legjislacionit shqiptar.
 - AMC thekson që AKEP duhet të kishte pergatitur një model të ri kostoje për tarifat e terminimit, pasi ka pasur dhe ka në dispozicion të gjitha burimet e nevojshme për të bërë një gjë të tillë, gjë të cilën nuk e ka kryer gjatë kësaj kohe.
 - AMC shprehet kundër aprovimit final të AKEP për rishikimin e tarifave të terminimit sipas *glide-path-it* të vendimeve nr. 2431 dhe nr. 2433, datë 13.3.2014 dhe për këtë arsye ankimon këto vendime të AKEP.
 - AMC shprehet se, reduktimi i tarifave të terminimit të vendosura nga AKEP do të shkaktojë efektin e kundërt në lidhje me pritshmërinë që ka AKEP përse i përket nivelit të tarifave me pakicë dhe politikave tarifore, pasi kemi të bëjmë me një vendim diskriminues për operatorët, i cili favorizon qarte Albtelecom dhe Plus ne kurriz të AMC.
 - AMC shpjegon se rifutja e asimetrisë do të sjellë një situatë që operatorët që do të kenë kosto më të larta të bëjnë diferencim të mëtejshem drejt rrjeteve me kosto më të lartë. Simetria e plote midis rrjetave i vendos operatorët në kushte të barabarta konkurrence dhe krijon stimul për reduktimin e diferencës së tarifave *net off* si dhe diferencën e tarifave *off net* kundrejt rrjeteve të ndryshëm. Kjo asimetri do të reflektohet tek tarifat kundrejt abonentit i cili do të mendohet se kë rrjet po telefonon në mënyrë që të optimizojë kostot e tij duke krijuar stimul për përdorim e më shumë se sa një SIM, duke stimuluar barrierat midis rrjeteve.
 - Miratimi i rishikimit për reduktim të mëtejshëm të tarifave të terminimit argumenton AMC, nuk është i mbështetur në asnje përlllogaritje kostosh reale që manifestojnë operatorët në aktivitetin e tyre komercial dhe nuk favorizon planet afatgjata te biznesit që kanë hartuar .

Në përfundim këtij ankimi administrativ ndaj Vendimeve të AKEP, nr. 2431 dhe nr. 2433, datë 13.3.2014, për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet e telefonisë celulare, duke qënë përpara një akti të paarsyetuar dhe të nxjerrë në kundërshtim me parimet rregullatore të BE si një nga burimet e së drejtës në këtë fushë, AMC kërkon:

a) Revokimin e akteve administrative të AKEP:

- Vendim nr. 2412, date 16.1.2014 për “Rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet e telefonise celulare”;
- Vendim nr. 2431, datë 13.03.2014 për “Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për “Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare””;
- Vendim i AKEP nr. 2433, datë 13.03.2014” Miratimi i rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik të lëvizsëem të sipërmarrësit Albanian Mobile Communication sh.a”, dhe heqjen e asimetrise së tarifave të terminimit në rrjetet celulare midis operatoreve;

b) Lënien në fuqi të *glide-path*-it për tarifatat e terminimit në rrjetet celulare të përcaktuar me anë të vendimeve përkatëse të AKEP me Nr. 2118 – 2122, dt. 4.7.2012 deri në kryerjen e analizës së ardhshme të tregut të telefonisë celulare;

c) AKEP të fillojë përgatitjen e një modeli të ri kostoje sipas metodologjisë LRIC siç përcaktohet nga Rekomandimi i BE-së të vitit 2009, në bashkëpunim me operatorët e tjerë mobile, për llogaritjen dhe përcaktimin e kostove të terminimit në rrjetet celulare.

3. AKEP pasi ka shqyrtuar ankimin e AMC vlerëson se:

- a. Në lidhje me pretendimet e AMC për mungesën e bazueshmërisë ligjore të vendimeve e datës 13.03.2014 për tarifatat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, AKEP ka dhënë sqarime dhe argumentimin në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik si dhe në dokumentin “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”, miratuar me VKD nr.2431, datë 13.03.2014 dhe publikuar në faqen e Internetit të AKEP, së bashku me vendimet dhe dokumentin final të MTR.
- b. Në lidhje me pretendimet e AMC për metodën e përzgjedhur ‘benchmark’ v ‘kosto LRIC’, AKEP ka dhënë argumentimin në dokumentat e publikuar dhe njëkohësisht në qëndrimin e dhënë për komentet e AMC të dhëna gjatë këshillimit publik, të publikuar në dokumentin “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”.
- c. Pretendimet e AMC për rritje të kostove të AMC për thirrjet drejt Albtelcom dhe Plus për shkak të rritjes së asimetrisë në përqindje janë të pabazuara, pasi megjithëse asimetria në përqindje është rritur, niveli I tarifave të terminimit të Albtelcom dhe Plus është reduktuar, dhe është niveli i tarifës së terminimit në rrjetin e një operatori tjetër ai që ndikon në koston e thirrjes off-net drejt këtij operatori. Pra kostot e AMC për thirrjet drejt Albtelcom dhe Plus realisht janë ulur dhe sic është theksuar në dokumentin final të MTR, AKEP pret refekteime nga operatorët për reduktim të tarifave off-net dhe diferencës së madhe të tarifave on-net/off-net.
- d. Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet celulare është përcaktuar nga AKEP jo vetëm në kuadrin e analizave të tregut por edhe në momente kohore dhe procedura të ndryshme (zgjidhje mosmarrëveshje, MTR sipas BULRAIC), ndërkohë që në analizat e tregut të radhës ka ri-shqyrtuar nivelet e vendosura më parë, duke bërë korrektimet e nevojshme (p.sh. Analiza e tregut 2012). Pra, Analiza e tregut celular do të rishikojë dhe efektet e nivelit të tarifave të terminimit në rrjetet e secilit operator të vendosura më 13.03.2014, përfshirë nevojën për korrektime të mundshme të nivelit të tarifave të terminimit të thirrjeve për krijimin e kushteve sa më të barabarta të konkurrencës midis operatorëve në treg.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, __, të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të Vendimeve Nr.2412, datë 16.01.2014, Nr.2431 dhe Nr.2433, datë 13.03.2014 të KD të AKEP dhe rrëzimin e ankimit të Albanian Mobile Communications sh.a. depozituar në AKEP me anë të shkresës nr. 337/1Prot., datë 10.4.2014.
2. Tarifat e terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendimet nr.2431-2435, datë 13.03.2014, të Këshillit Drejtues të AKEP, të jenë objekt vlerësimi i Analizës së rradhës së tregut celular.
3. Të njoftohet Albanian Mobile Communications sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**